

Data **27.02.2023**

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Rikonstrukcion shkolla MB “Besnik Hidri” Shenvlash”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **Kodi**

CPV: 45210000 -2- Punime ndërtimi

VLERA E FONDIT LIMIT **46 629 688** (dyzete e gjashte milion e gjashteqind e njezet e nente mije e gjashteqind e tetedhjetë e tete) lekë pa TVSH.

Afati i realizimit të punimeve është 112 ditë

Garancia per mbulimin te difekteve ,që mund te lindin gjatë shfrytëzimit të objektit , nga ana e firmës të jetë 2 vjet .

Argumentim:

MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Në zbatim të urdhërit të grupit të Specifikimeve nr. 1405prot. datë 03.02.2023 nr.70 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përlllogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

1. Dokumenteve sipas VKB Nr.150, datë 22.12.2022 “Per miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2023 të miratuara nga Këshilli Bashkiak”.
2. Shqyrtoi dokumentat e mësipërme dhe programoi punën për grumbullimin e informacionit, lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, të hartuar nga: Grupi i Specifikimeve Teknike pjesë e drejtorisë së projekteve dhe infrastruktures publike.

PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet teknike të hartuar nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastruktura, objekt i këtij prokurimi.

Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit Nr. 162 , datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TE KONTRATËS

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, Mbështetur në Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 dhe VKM, Nr 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 76, sipas të cilit:

Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga

autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Afati i realizimit të punimeve është 112 ditë.

Garancia per mbulimin e difekteve, që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të objektit , nga ana e firmës të jetë 2 vjet.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuara, vendosur dhe perllogaritur nga struktura të posacme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punes për hartimin e specifikimeve teknike dhe perllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”si dhe nenit

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit apo nevojën që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 46’000’000 lekë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për

njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa e mesiperme është bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe mbështetet në nenin 77, pika 3, e LPP, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43, b

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin 9920 date 19.05.2008, Per Procedurat Tatimore , neni 64 Deklarata Tatimore

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar, i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit..

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe neni 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës

2.2.3 Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2022 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar , si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetedeklarimit sipas shtojcës 8 në DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kjo kerkese bazohet ne Ligjin nr.9632,date 30.10.2006 ,Per sistemin e taksave vendore i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 23’000’000 Lekë, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 92’000’000 lekë.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Vërtetime të lëshuara nga një autoritet/ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. të shoqëruara me formular vlerësimi sipas shtojcës 9.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, kërkohet: ,Vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar fondit limit sipas nenin 39, pika 5 ”Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Aftësitë teknike dhe profesionale te tjerat si me poshtë janë hartuar, vendosur dhe perlllogaritur nga struktura të posacme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punes për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të

Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë , e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- NP-1 A – Punime gjurmimi në tokë
- NP-2 A – Ndertime civile dhe industriale
- NS-1 A– Punime per prishjen e ndertimeve,
- NS-2 A– Impiante hidro-sanitare , kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre
- NS-4 B– Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami.
- NS-14 A– Impiante te brendshem, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1 A	Punime gjurmimi në	Gjurmim dheu themele me makineri + transporti	0-20 mln leke	34 890 Leke

	tokë	Germim dheu me makineri Cilindrim shtresash me rul		
NP-2 A	Ndertime civile dhe industriale	Plinta e bazamente b/a monolite deri 20 m ³ C - 16/20 F V hekur betoni periodik Ø > 10 mm (Plintat) Shtrese beton C12/15 Shkallet e emergjences me konst.metalik te perbere Mbulim me panele sandwich (Shkalla) Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri Shtrese betoni C 12/15 10 cm (Per sheshet para palestres) F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm(Per sheshet para palestres) Shtrese lluster cemento 1:2 (Fusha Palester) Beton C20/25 shkalle dhe rampa tek shkallet hyrese F V hekur betoni periodik Ø > 10 mm F V konstruksione metalike te thjeshta (Streha jasht). Mbulim çatie me panele sandwich (Streha jasht)	0-20 mln leke	5 554 248 Leke
NS-1 A	Punime per prishjen e ndertimeve	Prishje suvatimi parapeti shkallet Prishje shtresa pllakash dyshemeje Prishje suvatim i jashtem t= 5cm Prishje suvatim muri i brendshem Prishje suvatim tavani t=3 cm Prishje mur tulle pa pastrim Heqje pllaka muri Prishje shtresa betoni Cmontim Panele Sandwic Cmontim - heqje dyer dritare Transport i mbeturinave me auto deri 5 km	0-20 mln leke	2 092 883 Leke
NS-2 A	Impiante hidro-sanitare ,kuzhina, lavanterisë së gazit dhe kundër	F.v tub e rakorderi linje jasht PE Ø 50mm PN16 F.v tub e rakorderi 1½ " PN 16 furnizim depo PN16 F.v tub e rakorderi 1" PN 16 furnizim depo PN16	0-20 mln leke	3 588 258 Leke

	<p>zjarrit, , mirembajtja e tyre</p>	<p>F.v tub e rakorderi ujesllesesi ¾ "</p> <p>F.v tub e rakorderi ujesllesesi ½ "</p> <p>F.v saracineske 2"</p> <p>F.v saracineske 1" , ½ " , ¾ "</p> <p>F.v kundra valvul</p> <p>F V rezervuari zingato 2000 litra</p> <p>F.v pileta dysHEMEJE</p> <p>F V bolier 80 liter, uje te ngrohte</p> <p>F.V wc alafrenga komplet</p> <p>F.V lavaman porcelani me mishilator komplet</p> <p>F.V bide importi porcelani</p> <p>F.V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=250 mm</p> <p>F.v tuba Pvc shkarkimi Ø 40,50,110,120</p> <p>Pusete kuz 0.8x0.8x1.0</p> <p>F.V Tubo PP magjistrali i rrudhosur Ø 200 mm</p> <p>F V pompe me pulmon 24 litra F.V Tubo çeliku pategel (Mannesmann ose ekuivalent) Ø 1¼"</p> <p>F.V Tubo çeliku pategel (Mannesmann ose ekuivalent) Ø 1"</p> <p>F.V Tubo çeliku pategel (Mannesmann ose ekuivalent) Ø ¾"</p> <p>F.V Kolektor shpendares 1" (6+6)</p> <p>F.V Kolektor shpendares ¾" (4+4)</p> <p>F.V Kasete kolektori</p> <p>Termoizolim tubi Ø ¾" me armofleks ose ekuivalent (d28x9)</p> <p>Termoizolim tubi Ø 1¼" me armofleks ose ekuivalent (d42x9)</p> <p>Termoizolim tubi Ø 1½" me armofleks ose ekuivalent (d54x9)</p> <p>Termoizolim tubi Ø 2½" me armofleks ose ekuivalent (d76x9)</p> <p>F.V Tubo PEX/al,DN 12 (Ø16 X 2.0) mm, i termoizoluar δ= 6mm</p> <p>F.V tuba bakri e rakorderi d = 15x1 mm</p> <p>F.V tub te zeze DN 65 [2 1/2"] dhe rakorderi</p> <p>F.V tub te zeze DN 40 [1 1/2"] dhe rakorderi</p>		
--	--	---	--	--

		<p>F.V tub te zeze DN 32 1 1/4"] dhe rakorderi</p> <p>F.V element radiator me llamarine 600x200 mm 1,5 kw</p> <p>F.V. Kanal I tymrave me llamarine çeliku, me shtrese izioluese 220/270 mm .</p> <p>F.V. Shtrese izolimi me lesh xhami me trashesi 25 mm</p> <p>Furnizim instalim tub xingato DN-2" (57x3mm)</p> <p>Rakorderi, pjese speciale</p> <p>Fikes zjarri me shkume ne koridore</p> <p>Hidrant zjarrfikes DN-2" komplet me kaseten dhe tubin e gomes dhe kaseten</p>		
NS-4 B	<p>Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami.</p>	<p>Veshje kornize llamarine xingat</p> <p>Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100 mm</p> <p>Kasete shkarkimi me llamarine xingat</p> <p>Shtrese me pllaka gres ne tualete + ambiente teknike ngjtur me kolle</p> <p>Veshje me pllake majolike (nyje sanitare + dhomat e zhveshjes + amb teknike)</p> <p>Veshje shkalleve te brendeshme/jashteme me pllaka mermeri t = 3cm</p> <p>Plintuse grez importi, h = 10 cm</p> <p>Veshje muri me polisterol te thjeshte t=5cm + rrjete + suva.(+Pragje dritare)</p> <p>Shtrese pllaka mermeri t = 3cm (pragje dritare)</p> <p>Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 25</p> <p>Suva solete h ~ 4 m me drejtues, me krah</p> <p>F V dritare plastike me dopio xham (Me mek Antiribalt Hapje)</p> <p>F V vetrate d/alumini plastike me dopio xham (Dyert Emergjence + Hyrja)</p> <p>F V dyer te brendeshme druri.</p> <p>Dyer d/alumini tek xham.(Tualetet)</p> <p>F V dyer te brendeshme druri me</p>	20-51 mln leke	27 881 802 Leke

		<p>xham te temperuar per klasat</p> <p>F.V. Kapak metalik per daljen ne trarace</p> <p>F.V. Dyer metalike ne ambiente teknike</p> <p>Dyer te blinduara importi.(Zyra Drejtorit+Financ)</p> <p>Bokse Alumini per WC (m2)</p> <p>Lyerje e fasades me boje hidroplastike importi cilesi e I-re</p> <p>Lyerje tavane me boje hidroplastike</p> <p>Lyerje muret e brendshme me boje hidroplastike</p> <p>Boje vaji sipërfaqe metalike</p> <p>Shtrese niveluese elastike me resin akrilike 3mm (Fusha Palester)</p> <p>Vizime me boje resin akrilike d=8cm (Fusha Palester) Shtrese me pllaka vetëbllokuese,(Me Vrima Per Kalimin e Ujit para palestres)</p> <p>Shtrese me pllaka vetëbllokuese, (Gri Drejtekendore para palestres)</p> <p>Ndenjese beton/arme 180x45 h-50 te parafabrikuara + shtrese derrase</p> <p>Tavolina lojtrash dhe ndenjese betoni veshur me rezin akrilik (m3)</p> <p>Tavolina ping pongu betoni veshur me rezin akrilik (m3)</p> <p>Veshje me panele sanduich (Pjesa anesore palestra)</p> <p>Dritare d/alumini dyfi xh.(Pjesa anesore palestra)</p> <p>Veshje kornize llamarine xingat (Kulmet dhe pjesa anesore palestra)</p> <p>Veshje muri me gomine speciale $\delta = 42\text{mm}$</p>		
NS-14 A	Impiante te brendshem, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV	<p>F.V Kasete plastike KE me 12 modular (vende)</p> <p>F.V Kasete plastike KE me 36 modular (vende)</p> <p>F.V Kasete plastike KE me 48 modular (vende)</p> <p>Panel I matjes se energjise 1/3 fazor, 10 poste</p>	0-20 mln leke	2 742 513 Leke

		<p>Automat termo-elektro magnetik,4P;380V;100A</p> <p>Automat magneto-termik 380V,25A, 4P</p> <p>Automat termo-elektro magnetik,4P;380V;40A</p> <p>F.V. automat termo.manjetik diferencial 1f220v,32Adl=0,03A</p> <p>F.V. automat termo.manjetik diferencial 2p220v,20Adl=0,03A</p> <p>F.V. automat termo.manjetik diferencial 2p220v,16Adl=0,03A</p> <p>F.V. Lampa sinjalizimi 220v 1,2w</p> <p>F.V. kuti shperndarese PT7,PT8, PT11</p> <p>F.V percjelles PV-500 Ø 1 mm2 per sirene e brendeshme</p> <p>F.V percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2</p> <p>F.V percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2</p> <p>F.V percjelles PV-500 Ø 4 mm2</p> <p>F.V percjelles PV-500 Ø 10 mm2</p> <p>F.V percjelles PV-500 Ø 6 mm2</p> <p>F.V.ne toke kablllo Cu fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese plastmasi, te armuar, 4x25mm2</p> <p>kabell interneti cad 6</p> <p>F.V. Percjelles CU per tokezim d=25mm2 I zhveshur</p> <p>Tub shllang Ø 32-36mm</p> <p>Tub shllang Ø 14-17mm</p> <p>Tub shllang Ø 22-26mm</p> <p>Çelsa nje polar 10A 280V komplet</p> <p>F.V kuti suport pllaket 2 modular</p> <p>F.V priza shuko jashte murit 2P+T IP=54</p> <p>Priza shuko universale Komplet</p> <p>F.V priza bivalente 220V 10A 2P-T</p> <p>FV Priza trefazore me tokezim 25A 280V komplet</p> <p>Priza per internet komlet</p> <p>Ndricues Katror LED 50w , 4000-6000K,3200lm, 600*600mm</p> <p>Ndricues katror LED me 18w , 4000K,1800lm,</p> <p>F.V Ndricues mural per ambientet e shkallve</p>	
--	--	--	--

		16 Port Rackmount Switch profesional FVSirene e brendeshme audio vizive FV Sirene e jashteme Ndricules projektor 100 wat per ambiente te jashtme te shkolles +palestra FV ndricues evakuimi 1x11wIP40 FV Fiber Optike, 8 core, Multi Mode per instalim Shirit tok hekuri zingato 30x3 mm , + zbritje Maja rrufepritesezingato Dn-16mm,L0,5m Elektroda tokezimi komplet 2'' puseta kontrolli 40x40x40 per matje te tokezimit Fiksues te konturit ne parapet Fiksues te shkarkueses ne fasade		
--	--	--	--	--

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1(një)

Për stafin e sipërcituar të disponoje dokumentacion që vërteton profesionin si: diplomat e inxhinierëve dhe kontrata pune.

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.

2.3.4. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Inxhinier ndertimi 1 (nje)
- Inxhinier elektrik 1 (nje)
- Inxhinier hidroteknik 1 (nje)
- Teknik ndërtimi 1 (nje)
- Punëtoresh ndertimi te thjeshte 23 punonjes

Për stafin e sipërcituar të disponoje dokumentacion që vërteton profesionin si: diplomat/deshmi profesionale e teknikut te ndertimit ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune.

Ndërsa për punëtorë të thjeshtë, të disponoje një vetëdeklarim nga shoqëria, ku listohen si punëtorë të thjeshtë.

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- Manovratorë 1 punonjes
- Drejtues mjete per automjetet e kerkuara 3 punonjes
- Hidraulik 2 punonjes
- Elektriçist 2 punonjes
- Murator 3 punonjes
- Bojaxhi 5 punonjes
- Saldator 2 punonjes
- Karpentiere 1 punonjes
- Hidroizolues 2 punonjes
- Pllakashtrues 6 punonjes

Për stafin e sipërcituar të disponoje dokumentacion që vërteton profesionin si: dëshmi profesionale të punonjësve ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune.

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinier Ndërtimi** është i nevojshëm që të zbërthejë projektin gjatë zbatimit në mënyrë të detajuar nga ana strukturore të konsultojë stafin mbështesës gjatë punimeve te nderyshme ne objekt.
- **Inxhinieri Elektrik** është i nevojshëm per ndjekjen e punimeve elektrike.
- **Inxhinieri Hidroteknik** është i nevojshëm per ndjekjen e punimeve hidraulike.

- **Tekniku i Ndërtimit** është i nevojshëm për zbatimin e të gjitha punimeve ndërtimore në baze të zërave të preventivit duke ndjekur me përpikmëri kushtet teknike të zbatimit si dhe të jete përgjegjës për koordinimin e punës në kantierin e ndërtimit.
- **Drejtuesit e mjetit** janë të nevojshëm për drejtimin e mjeteve transportuese si kamion dhe autobetoniere
- **Manovratorët** janë të nevojshme për drejtimin e mjetit fadrome
- **Hekurthyesit dhe karpentierët** duhen për realizimin në vend të strukturave beton arme sipas projektit (Plitat dhe strukturat e betonit në objekt)
- **Saladatorët** duhen për realizimin dhe montimin e strukturave prej hekuri sipas projektit (Shkallet e emergjences dhe punimet në elementet e demtuar të veshjes së palestres)
- **Hidraulikët** janë të nevojshëm për zbatimin e punimeve hidraulike vendosjen e tubave të ndryshëm sipas zërave të preventivit.
- **Elektricitetët** janë të nevojshëm për zbatimin e punimeve elektrike instalime dhe vendosje pajisjesh në baze të zërave të preventivit
- **Muratorët** janë të nevojshëm për ndërtimin e mureve të tullave të tipeve të ndryshëm si dhe suvatimet e jashtme dhe të brendshme sipas projektit dhe zërave të preventivit.
- **Hidroizoluesit** janë të nevojshëm për hidroizolimimin e sipërfaqeve të tarracave apo ,mureve në baze të pershkrimit në projekt dhe zërat e preventivit.
- **Bojaxhinjtë** janë të nevojshëm për realizimin e lyerjes me boje sipas zërit të preventivit në gjithë sipërfaqen e llogaritur në projekt.
- **Pllakashtruesit** janë të nevojshëm për realizimin e shtrimit të pllakave sipas zërit të preventivit në gjithë sipërfaqen e llogaritur në projekt.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 55 persona**, në listpagesa sipas formularëve standart për sigurimet, për muajin e fundit, të cilit i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës. Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi (*nëpërmjet formës elektronike*).

Ky kriter përmbushen nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **55 persona**.

Numri prej **55 punonjës** përfshin **23 punëtorë të thjeshtë + 32 persona** janë stafi i kualifikuar i inxhinierëve dhe teknikëve, drejtues mjeti, murator, hekurthyes, karpentier bojaxhinj të përmendur më lart. Ky numër është llogaritur analitikisht në grafikun e punimeve duke përdorur orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv për kohën kur shënohet piku i punimeve gjithashtu për llogaritjen e numrit të punonjesve janë marrë parasysh kombinimet e mundshme të punonjësve të specializuar dhe atyre të thjeshtë.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Lloji Makinerive	SASIA
<i>Automjete vetshkarkuese me mase maksimale te autorizuar 3.5-7.5 ton</i>	<i>2 copë</i>
<i>Automjete vetshkarkuese me mase maksimale te autorizuar mbi 7.5-18 ton</i>	<i>1 cope</i>
<i>Autobetoniere</i>	<i>1 copë</i>
<i>Skela</i>	<i>1250 m2</i>
<i>Fadrome</i>	<i>1 cope</i>

Argumetimi:

Mjetet e mësipërme kërkohen: duke u bazuar në proceset e punës, volumet e punimeve të preventivit të kryera gjatë periudhës më të ngarkuar (pikut) duke marrë parasysh gjithashtu edhe kombinimet e mundshme të punes se mjeteve në kantjer.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas Vendimit nr. 629, datë 15.7.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre (ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018) dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, ”Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata

- **Certifikat:** ISO 9001 -Sistemi i Menaxhimit të cilesisë, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi:

Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

- Certifikat: ISO 45001 : 2018 - Sistemi i manaxhimit te sigurise dhe shendetit ne vendet e punes, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi:

Sistemi i manaxhimit te sigurise dhe shendetit ne vendet e punes mundeson qe çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3. 9 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, neni 45 Seksioni III VKM 285, datë 19.5.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK “Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet **në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave**”

Specifikime teknike, projekti, preventivi, grafiku dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT, me të dhenat e mëposhteme:

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri Bashkia Durrës
Adresa Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës
Tel/Faks 052 22 23 10
E-mail info@durres.gov.al
Ueb-faqe www.durres.gov.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur Punë

3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-60600-02-27-2023

4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: Rikonstrukcion shkolla MB “Besnik Hidri” Shenvlash

5. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Kodi CPV: 45210000 -2- Punime ndërtimi

6. Fondi limit: 46 629 688 (dyzete e gjashte milion e gjashteqind e njezet e nente mije e gjashteqind e tetedhjetë e tete)lekë pa TVSH.

7. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 112 ditë

8. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: **15.03.2023** Ora 10.00

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Emiriana Sako